

Teuta Iljazi, PhD¹

UDC: 37.018.43:004]:616.98:578.834}-036.21

**OPINIONI I STUDENTEVE PËR MËSIMDHËNIEN ONLINE
GJATË PANDEMISË COVID-19**

**МИСЛЕЊЕ НА УЧЕНИЦИТЕ ЗА ОНЛАЈН НАСТАВАТА ЗА
ВРЕМЕ НА ПАНДЕМИЈАТА СОВИД-19**

**STUDENTS OPINION ABOUT ONLINE TEACHING DURING
THE COVID-19 PANDEMIC**

Abstract

The Covid-19 pandemic forced educational institutions to conduct their teaching entirely online. Online teaching pushed educational institutions to adapt in different ways to prevent the spread of the virus on the one hand, while on the other hand this was the only way to avoid interruptions in the teaching process. Online teaching in the Republic of Northern Macedonia found most of the educational institutions unprepared in terms of having the necessary equipment from both sides (teacher, student), as well as in terms of experience in online teaching. Knowing that this type of teaching is carried out at a distance, there was a lack of technical support and internet connection quality. This study examines the opinion of students at the University of Tetova regarding online teaching. Students express their opinion about the success of online teaching. The instrument used is an online questionnaire completed by 37 students, although a larger number of questionnaires were distributed. After processing the questionnaires, it was concluded that 76% of students prefer the traditional teaching (physical presence),

¹ Associate Professor, University of Tetova, Faculty of Pedagogy, Tetovo, North Macedonia E-mail: teuta.iljazi@unite.edu.mk

while 19% of students prefer the hybrid teaching. This study confirms the hypothesis: Students' opinion about the type of preferred teaching method is correlated with the success rate of the online teaching process ($\rho = 0.407$, $p < 0.01$).

Keywords: online teaching, teaching management, student motivation

1. Hyrja

Pandemia Covid-19 shkaktoi ndryshime të mëdha në shumë fusha në Botë që është lidhur direkt me jetën e njerëzve duke shkaktuar shumë shqetësime në sektorin shëndetësor, sektorin ekonomik apo atë të turizmit. Sektori i arsimit gjithashtu është ndikuar nga kjo pandemi duke filluar prej nivelit më të ulët gjer tek ai i nivelit të lartë. Ndryshimet dhe të papriturat janë në procesin e mësimdhënies dhe në procesin e të nxënit. Universitetet për një kohë të shkurtër ishin të detyruara të adaptohen me rrethanat e reja të krijuara duke e transformuar mësimdhënien nga klasat me prezencë fizike në klasa virtuale me platforma të ndryshme. Adaptimi në këtë lloj rrethanash nuk merrej parasysh sepse kjo ishte mënyra e vetme për të tejkaluar dhe menaxhuar situatën që virusi mos të përhapet nga njëra anë dhe mos të ketë ngecje procesi i mësimdhënies nga ana tjetër. Të dhënat e UNESCO² -s (2020) tregojnë se që nga prilli 92% e studentëve në botë janë prekur nga jeta e tyre arsimore. Gjersa në mars numri i vendeve që mbyllën shkollat ishte gjashtë, ky numër u rrit në 195 një muaj më vonë. Kjo tregon se sa serioze është kjo pandemi dhe sa është i rrezikuar njerëzimi.

Në përgjithësi mësimdhënia dhe të nxënët online ka qenë prezente vetëm si alternativë e mësimdhënies tradicionale, gjegjësisht mësimdhënies me prezencë fizike. Por, gjatë pandemisë Covid-19 ajo u shndërrua në një domosdoshmëri, e cila i gjeti institucionet arsimore disa më shumë të përgatitura e disa më pak të përgatitura. Mësimdhënia online (ose në largësi) ka një histori, e cila na dëshmon se varësisht zhvillimit të shkencës dhe teknologjisë ajo ka pësuar ndryshime të mëdha. Mësimdhënia në largësi së pari është realizuar me ndihmën e letërkëmbimit, më pas ajo realizohet me ndihmën e radios, TV, gjë që bëri dija të shpërndahet më lehtë dhe të jetë më gjithëpërfshirëse. Paraqitja e internetit

² United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization] (2020). *COVID-19 educational disruption and response*. Retrieved from <https://en.unesco.org/covid19/educationresponse>

bëri të mundur mësimdhënia të jetë nga largësia më e lehtë, më e suksesshme dhe realizimi të bëhet në kohë reale (sinkronike) në dallim nga ato të mëparshme që ishin asinkronike. Infrastruktura e TIK ka një rëndësi të madhe për realizimin e qëllimeve të përdoruesve (mësimdhënësit dhe studentët) që është e ndjekur nga shkathtësitë në TIK për të përfitur nga teknologjia e re si sfidë domethënëse. Në këtë mënyrë shihet nevoja për trajnim të vazhdueshëm teknik të të dy palëve. Shqetësimet e tjera kryesore nga të anketuarit në infrastrukturën e TIK-ut kanë të bëjnë me mos-disponueshmërinë e mbrojtjes antivirus së përditësuar në sistemet e tyre, mos-disponueshmërinë e lidhjes në internet me shpejtësi të lartë dhe çështjet e papajtueshmërisë me shumë media³.

Sistemet për mësimdhënie online janë sisteme të cilat duhet të plotësojnë kërkesat për shpërndarje, ndjekje, menaxhim të përmbajtjeve mësimore me ndihmën e internetit. Mësimdhënia online kërkon të mundësohet komunikim i dyanshëm i përdoruesve (mësimdhënës, student) duke u pasuruar me dërrasë të bardhë, dhoma për komunikim, forume, kuize si dhe vegla për vlerësim të studentëve. Këto gjëra mund të ofrojnë mënyra produktive dhe të përshtatshme për t'i arritur qëllimet e të nxënit⁴.

Në RMV më të përdorurat gjatë mësimdhënies janë Microsoft Teams, Google meet, Edmodo si dhe zgjidhjet për realizimin e video konferencave janë gjetur në Zoom ose Skype. Pandemia Covid-19 edhe në R. e Maqedonisë së Veriut shkaktoi ndryshime në procesin mësimor në të gjitha nivelet. Fillimi i pandemisë na gjeti të papërgatitur, posaçërisht arsimin fillor dhe të mesëm. Universitetet për një kohë të shkurtër u adaptuan në mjedisin e ri duke përdorur platforma të ndryshme mësimore, të cilat dita ditës u avancuan për shkak të kërkesave të ndryshme të përdoruesve në procesin mësimor. Mësimdhënia online në universitet filloi ta zëvendësojë mësimdhënien nga klasa me prezencë fizike në mësimdhënie në të ashtuquajturat klasa virtuale.

Mësimdhënia online, posaçërisht në kohën e pandemisë i ka benefitet e saj, sepse pikësepari ajo mundësoi që studentët të ndjekin mësim pa u rrezikuar nga virusi vdekjeprurës dhe së dyti ato nuk humbën nga mësimdhënia duke e stabilizuar procesin e edukativ. Në këtë kohë u bë e mundur që studentët nga vende të ndryshme të ndjekin mësimin të organizuar nga universitetet. Studentët gjithashtu përfituan edhe një përvojë për mësimdhënien online, sepse disa kishin përvojë më shumë e disa më pak. Studentët u bënë edhe më të pavarur gjatë realizimit të

³ M.Thanji & S. Vasantha, 2016.

⁴ Mukhtar K, Javed K, Arooj M, Sethi A, 2020

mësimdhënies online, sepse ata duke kërkuar burime të ndryshme interneti e pasuruan dijen, komunikimi ndërmjet studentëve u shtua për të realizuar dhe arritur suksesin e dëshiruar gjatë studimit.

Përveç anëve pozitive, mësimdhënia online i ka edhe anët negative të cilat kanë ndikuar për shqetësime të ndryshme si të studentëve ashtu edhe të mësimdhënësve. Problemet që janë paraqitur gjatë përvojës në mësimdhënien online kanë qenë mungesa e pajisjeve të nevojshme për mësimdhënie online, mungesa dhe ndërprerja e lidhjeve të internetit, mospërgatitja e mjaftueshme e studentëve dhe arsimtarëve për të ndjekur dhe për të realizuar mësimdhënien dhe të nxënët online. Për mësimdhënien online të realizuar gjatë kohës së pandemisë në vendin tonë mund të thuhet se ishte mundësi e vetme që mësimdhënia mos të ngeçë. Me përvojën në këtë lloj mësimdhënieje, furnizim jo i mjaftueshëm me mjete teknike, interneti jo stabil kanë qenë pengesë për realizim pa shqetësime të mësimdhënies. Orët e realizuara nga largësia sa kanë qenë të suksesshme në aspektin e menaxhimit, motivimit të studentëve, njohjen për aftësitë individuale të studentëve, mënyra e vlerësimit real të studentëve është qëllimi i këtij studimi.

Klasat, po edhe ato virtuale janë shumëdimensionale. Ato janë me plotë njerëz, detyra e afate që duhen përmbushur. Shumë individë, të gjithë me qëllime, parapëlqime dhe aftësi të ndryshme. Veprimet e ndryshme nëpër klasa mund të kenë efekte të ndryshme dhe të shuman-shme. Menaxhimi i orës mësimore si një term gjithëpërfshirës që ka të bëjë me mënyrat përmes të cilave mësimdhënësit organizojnë dhe kontrollojnë, sjelljen si dhe ndërveprimet me qëllim që mësimdhënia dhe të nxënët të jenë sa më efektive⁵. Menaxhimi i orës që realizohet online është një sfidë e re për mësimdhënësit. Kjo është sfidë sepse ka mungesë të mbështetjes si dhe mungesë e veglave dhe strategjive. Strategjitë, veglat të zhvilluara gjatë mësimdhënies me prezencë fizike të adaptohen në klasa virtuale për disa mësimdhënës është e lehtë për të adaptuar e për disa e vështirë. Një vështirësi që paraqitet gjatë mësimdhënies online është edhe ajo se studentët kyçen nga vende dhe ambiente të ndryshme të cilat shkaktojnë çrregullime në procesin e mësimdhënies. Prandaj bashkëpunimi me studentët të cilët kanë përvojë me mësimdhënien online është më se i dobishëm. Ky proces bashkëpunimi ndihmon në zhvillimin e mjedisit të mësimdhënies online⁶. Krijimi i një mjedisi të mësimdhënies së rregullt paraqet ndihmën për menaxhim më

⁵ B.Musai (2003)

⁶ Barbosa et al.,(2016)

të lehtë të mjedisit mësimor, njohje më të mirë të studentëve për të shfrytëzuar aftësitë e tyre individuale për diskutim, bashkëpunim si dhe vlerësim më objektiv.

Vlerësimi është një pikë mjaft e ndjeshme në procesin e mësimdhënies. Vlerësimi si pjesë e pandashme e procesit të mësimdhënies ka për qëllim të sigurojë informacion rreth përparimit të studentëve, t'u sigurojë studentëve informacion mësimor. Gjithashtu ka për qëllim të motivojë studentët, të sigurojë realizimin e objektivave aktuale si dhe të vlerësojë gatishmërinë e studentëve për nxënie në të ardhmen. Por a mund të realizohen këto elemente gjatë vlerësimit online? Gjatë vlerësimit online ekzistojnë testet e ndryshme, kuizet të cilat shërbejnë si vegla për vlerësim. Përdorimi i këtyre veglave dhe i veglave tjera varësisht nga natyra e lëndës nuk janë shumë të sigurta, sepse ekziston mundësia e keqpërdorimit duke shpërndarë të njëjtin studentëve tjerë. Në këtë rast mësimdhënësi duhet të jetë i vetëdijshëm për këto gjëra të cilat sjellin tek një vlerësim joreal.

Zhvendosja e mësimdhënies nga klasa tradicionale në një mjedis online e ndryshon rrënjësisht ndërveprimin njerëzor, komunikimin, paradigmat mësimore dhe teknikat e vlerësimit. Mësimdhënësi duhet të ketë kompetenca akademike në përmbajtjen e lëndës para zhvillimit të një mjeti efektiv të vlerësimit. Meqenëse metoda e ofrimit ka ndryshuar, mësimdhënësit gjithashtu duhet të ndryshojnë mënyrat se si ata demonstrojnë efektivitetin e mësimdhënies dhe të nxënimit⁷. Diskutimet qoftë në klasën tradicionale qoftë në atë virtuale janë nxitje për të njohur aftësitë individuale të studentëve. Kjo është mënyrë për të kuptuar thellësinë e të menduarit të studentëve. Diskutimet gjithashtu nxisin që studentët të shprehin idetë e tyre në lidhje me një problematikë, e cila gjë ndikon nga ana tjetër edhe për të kyçur studentët tjerë në shprehjen e zgjidhjeve alternative. Në këtë mënyrë mësimdhënësi është në gjendje të krijojë elemente (instrumente) të ndryshme vlerësimi të vendosura në portfolio online ku mund të ndiqet progresi i studentit si dhe vlerësimi i studentit të jetë më objektiv.

Universitetet i përgatisin studentët të jenë të gatshëm për të ushtruar profesionin që e kanë zgjedhur. Prandaj gjatë studimeve organizohet edhe mësimi praktik. Atëherë shtrohet pyetja si është e mundur nga largësia të realizohet mësimi praktikë? Mësimi praktikë nga disa mësimdhënës është realizuar me anë të simulimeve të ndryshme. Një pjesë e mësimdhënësve mësimin praktikë e kanë realizuar me ndihmën

⁷ Robles.M, & Braathen.S (2002)

e TIK që të arrihet tek nxënia që kërkohet. Duke pasur parasysh që përgatitja e mësimeve të reja kërkon gjithashtu mësim praktik, mësime online nëpër shkollë fillore ishte sfidë për mësuesit e ardhshëm, të cilët realizuan një praktikë ndryshe nga vitet e kaluara. Ata u përgatitën për të realizuar mësimin nga largësia duke mos përjashtuar ndihmën e ofruar nga vetë mësuesit e shkollave fillore. Kjo na shtyn të mendojmë që përveç metodikës të mësimin nga lënda përkatëse (në këtë rast lëndës së matematikës) studentët duhet përgatitur edhe për metodikën e lëndës përkatëse, por tani nga largësia. Kjo sipas meje për të përgatitur mësues të shkollës fillore, por edhe të mesme në një lëndë të caktuar, të cilën do ta realizojnë në profesionin që do ta ushtrojnë, së pari duhet përpiluar lënda si p.sh. “Metodika e mësimin online” prej së cilës do të rrjedhin lëndët tjera si p.sh. “Metodika e mësimin online të matematikës”. Kjo lëndë në përmbajtjen e vetë do të ketë parasysh një ambient virtual, ku duhet të përjashtohen emocionet, ku mjetet mësimore që do të propozohen do të jenë virtuale të cilat nxënësi nuk do të jetë në gjendje t’i prekë si në klasat me prezencë fizike. Metodën, format apo teknikat mësimore duhet të adaptohen me ambientin dhe klasën virtuale. Mësime dhe të nxënë online tek ne është në fazën fillestare, prandaj duhet menduar që e njëjta të përsoset që të jetë e zbatueshme në mënyrë më të mirë.

2. Metodologjia e hulumtimit dhe rezultatet

Në këtë studim si mjet hulumtimi është përdorur pyetësor online i shpërndarë të studentët me qëllim të mblidhen të dhëna për mendimin e studentëve në lidhje me karakteristikat e orës mësimore që është realizuar online. Për karakteristika janë shfrytëzuar karakteristikat e orës mësimore me prezencë fizike duke dashur të vijmë në përfundim suksesshmërinë e orës mësimore në largësi. Për karakteristikat e orës mësimore të realizuara online akoma nuk kemi të dhëna të mjaftueshme. Përvoja me mësimin nga largësia do të nxjerr në pah edhe cilat karakteristika duhet t’i posedojë ora online që të jetë e suksesshme. Studimet janë të pakta për mësimin online...

Pyetësori online është shpërndarë studentëve të Universitetit të Tetovës. Atë pyetësor e kanë plotësuar vetëm 37 studentë prej të cilëve 89.2% janë të gjinisë femërore. Studentët janë të fakultetit të shkencave shoqërore me përfaqësim 40.5%, shkenca matematiko-natyrore përfaqësohen me 3% dhe fakultete tjera 21 studentë ose 56.8%. Studentët janë të vitit të katërt dhe të vitit të tretë të studimeve. Meqë pandemia

na befasoi dhe detyroi në mësimbajtje online, një pyetje gjer te studentët ishte nëse ata kanë njohuri në lidhje me mësimdhënien online. Vetëm 8% e studentëve janë deklaruar se kanë njohuri nga mësimdhënia online (sinkronike), sepse mësimi online asinkronik përdoret në universitetin tonë në forma dhe vegla të ndryshme. Nga kjo e dhënë shihet që afërsisht 92% e studentëve janë jo të përgatitur dhe pa përvojë për këtë lloj mësimdhënieje. Por duke ditur që ata i takojnë një gjenerate të cilët kanë shkathtësi në përdorimin e TIK, studentët shumë shpejtë u adaptuan në ambientin virtual të mësimdhënies.

Përgjigjet e pyetjeve të pyetësorit që kanë të bëjnë me karakteristikat e mësimdhënies janë të shkallëzuara sipas shkallës së Likertit (me 1- aspak,...5 – gjithmonë). Ky pyetësor është i besueshëm dhe kjo dëshmohet me koeficientin Cronbach Alpha që është paraqitur në tabelën më poshtë, e cila me vlerën e saj(0.826) paraqet një besueshmëri të mirë ndërmjet elementeve të pyetësorit.

Reliability Statistics	
Cronbach's Alpha	N of Items
.826	12

Tab.1 Besueshmëria e pyetësorit

Kur bëhet fjalë për mësimdhënien online ajo mund të posedojë cilësi të ndryshme që varen nga mësimdhënësi se si e ka planifikuar realizimin, si dhe nga natyra e lëndës që zhvillohet. Mësimdhënësit për të realizuar qëllimin dhe objektivat mësimore në çdo nivel në procesin e arsimit përdorin mënyra dhe vegla të ndryshme. Këtë e dëshmon edhe Tab.2 ku në përgjigjen e pyetjes a është përdorur vetëm ligjërime verbal gjatë mësimdhënies online, 54,1% e studentëve janë përgjigjur që kjo mënyrë ka dominuar pak, ndërsa përgjigjja shumë dhe gjithmonë ka dominuar tek përafërsisht 35% e numrit të përgjithshëm të studentëve.

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	aspak	2	5.4	5.4	5.4
	shumë pak	2	5.4	5.4	10.8
	pak	20	54.1	54.1	64.9
	shumë	6	16.2	16.2	81.1
	gjithmonë	7		18.9	18.9
Total		37		100.0	100.0

Tab.2 Përgjigjet e studentëve për ligjërime vetëm verbal

Si vegël mjaftë e përhapur gjatë mësimdhënies haset Power Point. Ligjërimet të realizuara me këtë vegël dhe të përcjella me sqarime verbale sipas studentëve është e përfaqësuar mjaftë që d.m.th gjithmonë në 35.1% të përgjigjet e studentëve, shumë në dhe pak tek përgjigjet e 29,7% të studentëve pjesëmarrës në këtë studim (Tab.3)

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	shumë pak	2	5.4	5.4	5.4
	pak	11	29.7	29.7	35.1
	shumë	11	29.7	29.7	64.9
	gjithmonë	13	35.1	35.1	100.0
	Total	37	100.0	100.0	

Tab.3 Përgjigjet e studentëve në lidhje me përdorimin e Power Point të përcjellë verbalisht

Lënda si që është lënda e matematikës gjatë mësimdhënies ka nevojë për përdorim edhe të veglave tjera përveç atyre që u përmendëm më lartë. Këtë e theksoj sepse kjo lëndë, por edhe disa lëndë tjera kanë nevojë për vegla me të cilat do të shkruash, vizatosh njëkohësisht gjatë mësimdhënies, që d.m.th si që është tabela e klasave me prezencë fizike. Kjo vegël në fillimet e zbatimit të mësimdhënies online mungonte në shumicën e platformave, por duke parë këtë si të nevojshme platformat u avancuan. Sa janë përdorur vegla tjera gjatë mësimdhënies online në kohën e pandemisë e jep Tab.4.

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	aspak	3	8.1	8.1	8.1
	shumë pak	7	18.9	18.9	27.0
	pak	14	37.8	37.8	64.9
	shumë	6	16.2	16.2	81.1
	gjithmonë	7	18.9	18.9	100.0
	Total	37	100.0	100.0	

Tab.4 Përgjigjet e studentëve për përdorim edhe të veglave tjera gjatë mësimdhënies online

Nga tabela e mësipërme shihet që mjete tjera shtesë përveç atyre të zakonshmeve pak janë përdorur. Sipas mendimit tim shkakun ndoshta

është përdorimi i platformës së papërshtatshme për mësimdhënie, stafi mësimdhënës i papërgatitur mjaftueshëm, përdorimi i mjeteve teknike të papërshtatshme për këtë lloj të mësimdhënies. Duhet të theksohet që gjatë kohës së pandemisë edhe mësimdhënësit kanë kontribuar në masë të madhe për mbarëvajtjen e rregullt të mësimimit, sepse ata kanë vënë në dispozicion gjithë kapacitetin e tyre si njerëzor ashtu edhe teknik. Mësimdhënësit kanë shndërruar dhomat nëpër shtëpitë e tyre në klasa, internet i shtëpisë ka qenë në shërbimin e mësimdhënies, TIK-u që e kanë pasur në shtëpi e kanë vënë në dispozicion për mësimdhënie. Gjithashtu duhet të ceket që institucionet arsimore kanë qenë të papërgatitur për një zbatim kaq masovik të mësimdhënies nga largësia.

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	aspak	4	10.8	10.8	10.8
	shumë pak	9	24.3	24.3	35.1
	pak	9	24.3	24.3	59.5
	shumë	11	29.7	29.7	89.2
	gjithmonë	4	10.8	10.8	100.0
	Total	37	100.0	100.0	

Tab.5 Mendimi i studentëve për prezencën e mjeteve të mjaftueshme gjatë mësimdhënies online

Nga Tab.5 ku janë paraqitur rezultatet e të përgjigjeve të pyetjes në lidhje me mjetet mësimore a kanë qenë të mjaftueshme gjatë mësimdhënies online mund të arrijmë në përfundim që mendimet e studentëve janë të shpërndarë pothuajse njëllor në secilën shkallë të përfaqësimit. Prandaj përdorimi i TIK-ut në arsim duhet avancuar me pasurim të tyre me mjete, internet kualitativ si dhe me trajnime të stafit mësimdhënës, ku nuk duhet përfshirë edhe studentët dhe nxënësit pa të cilët nuk mund të realizohet asnjë lloj i mësimdhënies.

Një nga karakteristikat e mësimdhënies me prezencë fizike është edhe motivimi i studentëve që të arrihet të nxënësit sa më i mire. Sa kanë qenë studentët të motivuar gjatë kësaj mësimdhënieje në kohë të pandemisë e paraqet Tab.6

CENTRUM 16

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	aspak	3	8.1	8.1	8.1
	shumë pak	8	21.6	21.6	29.7
	pak	10	27.0	27.0	56.8
	shumë	12	32.4	32.4	89.2
	plotësisht	4	10.8	10.8	100.0
	Total	37	100.0	100.0	

Tab.6 Motivimi i studentëve gjatë mësimit online

Nga tabela e mësipërme të dhënat flasin që 27% e studentëve janë shprehur se kanë qenë pak të motivuar gjatë mësimit online, ndërsa 32% e studentëve janë shprehur se kanë qenë shumë të motivuar. Sa janë këto elemente prezente në mësimit online duhet hulumtuar që të jetë e mundur të përcaktohen cilat elemente gjatë mësimit online janë më motivues. A është e zhvilluar shkenca e metodologjisë së mësimit online, a kanë njohuri mësimit në lidhje me këtë? Mësimit gjatë mësimit online i përshtatin njohuritë e pedagogjisë së mësimit me prezencë fizike. Atëherë duhet cekur se kjo ka ndihmuar mjaftë, por a ka qenë e mjaftueshme duhet të jetë edhe një pyetje që mund të hulumtohet. Sa i takon menaxhimin të orës mësimore online flasin të dhënat e Tab.7. Këto të dhëna flasin që studentët (40,5%) janë të mendimit se orët gjatë mësimit online kanë qenë pak të menaxhuara mirë. Të menaxhosh mirë një orë mësimore në mënyrë të sukseshme duhet të gjitha kamerat të jenë të hapura, të cilën gjë nuk e mundëson internet jo cilësor. Të menaxhosh mirë një orë mësimore online nuk duhet të kesh ndërprerje në mësimit që shkakton shqetësim edhe tek studentët, po ashtu edhe tek mësimit. Menaxhimi i mirë realizohet po qe se të dy palët pjesëmarrës në mësimit kanë përvojë në këtë lloj të mësimit, kurse në këtë kohë të pandemisë gjithçka ka ndodhur në mënyrë spontane dhe qëllimi i vetëm ka qenë mos ngecja në procesin mësimor dhe pengimi i përhapjes së virusit.

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	shumë pak	9	24.3	24.3	24.3
	pak	15	40.5	40.5	64.9
	shumë	7	18.9	18.9	83.8
	plotësisht	6	16.2	16.2	100.0
	Total	37	100.0	100.0	

Tab.7 Menaxhimi i mësimit online

Studentët, secili person ka aftësi të ndryshme dhe në lëmi të ndryshme. Përpilimi i programeve mësimore bëhen në formën spirale dhe jo në atë lineare, me qëllim të respektimit të aftësive të nxënësve për pjesë të ndryshme. Që të respektosh aftësitë individuale të secilit gjatë procesit të mësimdhënies është paksa e vështirë, sepse secili nga nxënësit kanë natyrë të ndryshme. Kjo është edhe më e vështirë sipas meje gjatë mësimdhënies online. Mendimi i studentëve në lidhje me respektimin e aftësive individuale të studentëve gjatë mësimdhënies online është paraqitur në Tab.8.

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	aspak	7	18.9	18.9	18.9
	shumë pak	8	21.6	21.6	40.5
	pak	16	43.2	43.2	83.8
	shumë	4	10.8	10.8	94.6
	plotësisht	2	5.4	5.4	100.0
	Total	37	100.0	100.0	

Tab.8 Mendimi i studentëve për respektimin e aftësive individuale të tyre gjatë mësimdhënies online

Nga Tab.8 shihet qartë që mbizotëron mendimi i studentëve (43.2%) se pak respektohen aftësitë individuale të tyre gjatë mësimdhënies online.

Prania e keqpërdorimeve është edhe në mësimdhënien online. Këtë e vërejnë edhe mësimdhënësit, por shprehen edhe studentët. Keqpërdorimet janë të llojeve të ndryshme e posaçërisht gjatë mësimdhënies online. Studenti duhet të jetë me vetëdije shumë të lartë, i përkushtuar dhe mos të bjerë nën ndikimin e të tjerëve që të qëndrojë larg këtyre gjërave. Nga Tab.9 shohim që mendimet e studentëve janë të ndryshme. Nga numri i përgjithshëm i studentëve 35,1% prej tyre mendojnë që ka shumë pak keqpërdorime, 24,3% mendojnë që prezenca e keqpërdorimit gjatë mësimdhënies online është pak, ndërsa 10.8% e studentëve mendojnë që keqpërdorimet janë prezente plotësisht.

CENTRUM 16

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	aspak	8	21.6	21.6	21.6
	shumë pak	13	35.1	35.1	56.8
	pak	9	24.3	24.3	81.1
	shumë	3	8.1	8.1	89.2
	plotësisht	4	10.8	10.8	100.0
	Total	37	100.0	100.0	

Tab.9 Mendimi i studentëve për praninë e keqpërdorimeve gjatë mësimdhënies online

Gjithashtu duhet cekur që keqpërdorimet mund të eliminohen me përvojë të mirë, me mjete të avancuara për mësimdhënie, të cilat do të ndihmonin në eliminimin e keqpërdorimeve të mundshme nga ana e studentëve.

Përcjellja e studentit në mënyrë që të rritet efikasiteti i të nxënit paraqet një sfidë për mësimdhënësin e posaçërisht gjatë mësimdhënies online. Për ta njohur studentin është vështirë poqese ai qëndron në anën tjetër të kompjuterit sepse është e pamundur për ta përcjellë atë në situata të ndryshme. Mendimin e studentëve në lidhje me këtë e jep Tab.10.

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	aspak	6	16.2	16.2	16.2
	shumë pak	9	24.3	24.3	40.5
	pak	16	43.2	43.2	83.8
	shumë	2	5.4	5.4	89.2
	plotësisht	4	10.8	10.8	100.0
	Total	37	100.0	100.0	

Tab.10 Njohja e studentëve gjatë mësimdhënies online

Nga Tab.10 shihet se studentët (43,2%) mendojnë se ky lloj i mësimdhënies pak e bën të mundur njohjen e studentit. Gjithashtu ata ndajnë mendimin 24,3% nga numri i përgjithshëm i studentëve se shumë pak është e mundur të njihet student gjatë mësimdhënies online. Ka të tillë që mendojnë (16,2%) se aspak nuk është e mundur njohja e studentëve.

Pjesa më e ndjeshme e procesit të mësimdhënies është vlerësimi i studentëve. Mendimi i studentëve në lidhje me objektivitetin e vlerësimit gjatë mësimdhënies online është paraqitur në Tab.11

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	aspak	19	51.4	51.4	51.4
	shumë pak	10	27.0	27.0	78.4
	pak	4	10.8	10.8	89.2
	shumë	3	8.1	8.1	97.3
	plotësisht	1	2.7	2.7	100.0
	Total	37	100.0	100.0	

Tab.11 Mendimi i studentëve për vlerësimin objektiv gjatë mësimdhënies online

Nga Tab.11 vërehet se 51.4% e studentëve janë të mendimit që gjatë mësimdhënies online vlerësimi i studentëve është aspak objektiv, gjithashtu 27% prej tyre mendojnë vlerësimi është shumë pak objektiv. Për të vlerësuar sa më objektivisht studentët duhet pasur vegla vlerësimi të cilat do të sigurojnë objektivitet në vlerësim. Jo të gjitha veglat për vlerësim janë të përshtatshme për të gjitha lëndët mësimore.

Valid	aspak	25	67.6	67.6	67.6
	shumë pak	7	18.9	18.9	86.5
	pak	2	5.4	5.4	91.9
	shumë	2	5.4	5.4	97.3
	plotësisht	1	2.7	2.7	100.0
	Total	37	100.0	100.0	

Tab.12 Mendimi i studentëve për suksesshmërinë e mësimdhënies online

Studentët për suksesshmërinë e mësimdhënies online janë të mendimit se ajo nuk ka qenë aspak e suksesshme. Këtë mendim e kanë 67,6% e studentëve. Ky lloj i mësimdhënies nuk i ka plotësuar pritjet e tyre. Për ta tejkaluar këtë duhet pasur më shumë përvojë, mjete më të përshtatshme për këtë lloj të mësimdhënies si dhe platforma më të përshtatshme për mësimdhënie si dhe vlerësim. Kjo është paraqitur në

		Mjete mësimor	Motivim	Menaxhim	Aftësi individ	Keqpër dorime	Njohja student	Vlerë simi	Sukses shmëri	Mësimd preferua
Sukseshmëria e mësimdhënies online	Pearson Correlation	.476**	.445**	.547**	.476**	.336*	.410*	.636**	1	.407*
	Sig. (2-tailed)	.003	.006	.000	.003	.042	.012	.000		.012
	N	37	37	37	37	37	37	37	37	37
*. Correlation is significant at the 0.05 level (2-tailed).										
**. Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed).										
Pas shqyrtimit të literaturës dhe pas përpunimit të të dhënave të mbledhura me ndihmën e pyetësorit ky studim i sjell këto përfundime dhe propozime.										

Tab.12. Gjithashtu duhet thënë që 75,7% e studentëve preferojnë mësimdhënien me prezencë fizike, ndërsa 18,9% preferojnë mënyrën hibride.

Në këtë studim janë vërtetuar këto hipoteza:

H₁: Sukseshmëria e mësimdhënies online është në korrelacion me mjetet mësimore të nevojshme për mësimdhënien online (0.476, p<0.01)

H₂ : Sukseshmëria e mësimdhënies online është në korrelacion me menaxhimin e suksesshëm të mësimdhënies online (0.547, p<0.01)

H₃:Opinionin e studentëve në lidhje me llojin e mësimdhënies së preferuar është në korrelacion me sukseshmërinë e mësimdhënies online (0.407, p<0.01)

Vërtetimin e paraqet tabela e mëposhtme me vlerat e koeficientit të Pearsonit.

3. Conclusions and proposals

- Educational institutions must be equipped with the required qualitative tools for teaching.
- Educational institutions must be equipped with the qualitative internet to have an uninterrupted teaching process.
- Educational institutions should continuously prepare their teaching staff to use the modern teaching tools
- Educational institutions and state institutions under the umbrella of which the educational process is carried out should follow the innovations related to the educational process. This with the aim to prepare not only the teachers as providers of educational services, but also those who are recipients of these services, i.e., students.
- State educational institutions should equip students with the necessary technical tools to attend online teaching or create favorable

conditions for all participants in the educational process to be equipped with qualitative tools to provide qualitative teaching.

- Under normal conditions, educational institutions in their annual plan should have certain classes where teaching will be carried out online to improve and advance synchronous online teaching.

- Based on the student' opinion, student individual abilities are less respected when taught online. This means that more discussions and debates should be encouraged during the classes. In this way students can express himself / herself freely, his / her opinion, idea, suggestion, or proposal. Additionally, during online classes teachers can not get to know the student. Virtual classrooms do not allow this. In classes with physical presence the body language or wordless reactions carry signals which help the teacher to get to know the student better

- Most of the students who participated in this study think that their evaluation during online teaching was not objective. Online teaching and assessment platforms are not always appropriate, this is because not all the platforms are compatible with the nature of the subject. Therefore, one should work in that direction to choose the one that is most suitable.

- Most of the students think that online teaching has not been successful. Given that this has been the only way not to interrupt the teaching process during the pandemic, this way of teaching will achieve the expectations of both parties participating in this process only with its improvement and perfection.

- This study confirms the hypotheses that the success of online teaching is correlated with the management of online teaching, online teaching tools and students' preferred teaching.

Recensentë:

Prof. Dr. Metush Sulejmani

Prof. Dr. Afrim Osmani

4. Referenca

1.Barbosa, J., Barbosa, D., & Rabello, S. (2016). A collaborative model for ubiquitous learning environments. *International Journal on E-Learning*, 15(1), 5–25.

2. Carmen Carrillo & Maria Assunção Flores (2020) COVID-19 and teacher education: a literature review of online teaching and learning practices, *European Journal of Teacher Education*, 43:4, 466-487, DOI: 10.1080/02619768.2020.1821184

- 3..Hebebcı, M. T., Bertiz, Y., & Alan, S. (2020). Investigation of views of students and teachers on distance education practices during the Coronavirus (COVID-19) Pandemic. *International Journal of Technology in Education and Science (IJTES)*, 4(4), 267-282.
4. Kaur.K,&Kaur.J (2021) Online Learning Experience in India & Covid-19: An Empirical Analysis; IOSR Journal of Research & Method in Education,Vol.11.2
5. Kemp.N&Grieve R.(2014) Face-to-face or face-to-screen? Undergraduates' opinions and test performance in classroom vs. online learning. *Frontiers in Psychology*.
6. Muslimin, A. I., & Harintama, F. (2020). Online Learning during Pandemic: Students Motivation , Challenges , and Alternatives. *Loquen:English Studies Journal*, 60–68
7. Mukhtar, K., Javed, K., Arooj, M., & Sethi, A. (2020). Advantages, Limitations and Recommendations for online learning during COVID-19 pandemic era. *Pakistan journal of medical sciences*, 36(COVID19-S4), S27–S31. <https://doi.org/10.12669/pjms.36.COVID19-S4.2785>
8. Meenakshi Thanji &S.Vasantha (2016)ICT Factors Influencing Consumer Adoption of E-Commerce Offerings for Education *Indian Journal of Science and Technology*, Vol 9(32), DOI: 10.17485/ijst/2016/v9i32/98650, 2016.
9. Musai.B. (2003) Metodologji e mësimeve –botimi I II CDE Tiranë
10. Olasile Babatunde Adedoyin & Emrah Soykan (2020): Covid-19 pandemic and online learning: the challenges and opportunities, *Interactive Learning Environments*, DOI: 10.1080/10494820.2020.1813180
11. Robles.M, &Braathen.S (2002) Online Assessment Techniques *Delta Pi Epsilon Journal* 44 no1.
12. Selassie.A.E, Sackey.A.J , Agbogla. S,(2021) College, Students' Interest in Online Learning: The Effects of Covid-19, Lockdown and Accessibility of Resources, *IOSR Journal of Humanities And Social Science*, Volume 26, Issue 2, Series 1.
13. Sut Ieng Lei & Amy Siu Ian So (2021) Online Teaching and Learning Experiences During the COVID-19 Pandemic – A Comparison of Teacher and Student Perceptions, *Journal of Hospitality & Tourism Education*, 33:3, 148-162.
14. UNESCO [United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization] (2020). *COVID-19 educational disruption and response*. Retrieved from <https://en.unesco.org/covid19/educationresponse>